REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.8456/1 Prot.

Lushnje,më 16/10/2024

**PROJEKT-VENDIM**

**NR. 94 DATË 16/10/ 2024**

**"PËR DHËNIE TITULLI "QYTETAR NDERI I LUSHNJES" Z.NEBI SEFA (pas vdekjes)"**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij te datës / /2024, pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë "Për dhenien e titullit "Qytetar Nderi i Lushnjes për z.Nebi Sefa(pas vdekjes)", si dhe mbështetur në ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54, germa "m"; Ligjit 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendor te nderit ne Republikën e Shqipërise", Ligjit 94/2024 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit Keshilli Bashkiak, neni 11,pika 2;

**PROPOZOJMË:**

1. Të vlerësohet me titullin "Qytetar Nderi i Lushnjes" **z.Nebi Sefa** (pas vdekjes) me motivacionin:

*"Për kontribut të shquar atdhetar dhe patriotik në shtetformimin dhe shpalljen e Pavarësisë."*

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e QKKS.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**Drejtor i QKKS**

**Brizida Dervishi**

**Drejtoria Juridike**

**Bedri Hida**

Adresa: Lagjja "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LUSHNJE**
**KOMISIONI KËSHILLIMOR I DHËNIES SË TITUJVE VENDORË TË NDERIT**

Nr. 8184 prot.

Lushnje, më 08.10.2024

**VENDIM**

**NR 02 DATË 08/10/2024**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" kreu I, neni 3 germa "a"dhe "e" ,Kreu III neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 gërma "b", pika 1.3 gërma "a", pika 1.7 gërma "a" , Kreu X , neni 64 gërma "A", ligji nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë" , dhe Ligji 94/2022 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë",neni 11, pika 2,shkronja a, neni 17, shkronja a.

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Dhënies se Titullit të Nderit "Qytetar Nderi" pas vdekjes, për Z.Nebi Sefa dhe Z.Ikonom Dhima.
2. Dërgimin e dokumentacionit të paraqitur për miratim Titullarit të institucionit Bashkia Lushnje.

**KRYETAR**
**BRIZIDA DERVISHI**


Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

**Propozim për shpallje "Qytetar Nderi" pas vdekjes Firmëtarë i Pavarësisë**

**Nebi Sefa**

më 2 prill 1861 lindi Nebi Sefa, fëmija i parë. Pas tij erdhën në jetë edhe tre vëllezër e dy motra, Baja dhe Fatimeja. Nga vëllezërit jetoi vetëm Abazi, pasi dy të tjerët, Qamili dhe Jahjai ikën të rinj, si viktima të sëmundjeve të kohës. Nebi Sefa fëmijë bëri jetën e moshatarëve të familjeve të kamura. Luajti në oborrin e madh midis grupit të shtëpive të fisit, brodhi rrugicave të përbaltura të kohës; shkonte edhe nga tokat ku punohej me krahë pune të shtuara. Ai e nisi arsimimin në Lushnjë për ta vijuar në Berat. Nuk i mungonte asgjë për ta bërë jetën pa andralla. Shkrimin e leximin shqip i nisi herët, fshehurazi, sepse babai arsimdashës i sillte libra nga Rumania. Po, mësoi edhe osmanisht, madje edhe arabisht. I ati kishte lidhje miqësore në Kostancë, ndaj e dërgoi atje për studime të mëtejshme. Së fundi, Nebi Sefa kreu edhe një specializim në Selanik. Ai u kthye në Lushnjë djalë me formim të plotë, ndërkohë që ishte përfshirë herët në biznesin e familjes.

Siç ishte zakoni atëherë dhe si "*djalë beu*", ai mund të martohej herët. Por Nebiu, si në mjaft raste të tjera, ishte ndryshe. I dhënë pas punëve të shumta, "*harroi*" të martohej. Vetëm mbi të tridhjetat u lidh me një vajzë fshati nga fisi Pepa në Kosovë të Madhe. U lindën tre fëmijë. E para ishte Sabire, në vitin 1902 lindi Ismaili, i cili përtëriu emrin e gjyshit. Shumë vite më vonë lindi Qamili. Që nga martesa e tij e parë dhe deri te krushqitë për fëmijët është një periudhë mbi tridhjetëvjeçare. Është koha e bukur e fisnikërimit të këtij burri të ri, që, veç pasurisë, ruajti dhe zgjeroi miqësitë e të atit. Iliaz Pashë Vrioni, firmëtarë i pavarësisë, ministër, kryeministër i vendit e ministër fuqiplotë i Shqipërisë në Francë, sa herë kthehej nga Parisi në Berat, e kishte zakon të ndalonte një natë tek Nebi Sefa në Lushnje se ndryshe ai zemërohej. Të dy miqtë e hershëm kuvendonin për problemet ekonomike dhe të politikës ndërkombëtare. Interesant është edhe ky telegram. Më 1923, i mirënjohuri Mitat Frashëri, apo Lumo Skëndoja e njofton zotin Nebi se po vjen ta takojë në Lushnjë.



Telegram nga Mitat Frashëri

Pra, Nebi Sefa shumë shpejt u bë një nga biznesmenët më të suksesshëm të vendit dhe u rendit midis familjeve të mëdha të kohës, ku fitoi një emër fort të nderuar.

Dikur shpreheshin se në përgjithësi krushqitë ngjajnë, pa bëhen. E, pra, ky Nebi Sefa, që vet u martua me një vajzë të thjeshtë fshatare, me kohë lidhi krushqi me njerëz emërmëdhenj të vendit. Ismaili, djali i madh u martua me Sheriarin, të bijën e firmëtarit të Pavarësisë, Qemal bej Karaosmani, mbrojtës dhe sekretar i kryeministrit të parë të shtetit shqiptar. Prindërit ishin takuar bashkë tek shoqëronin Ismail Qemalin për në Vlorë, ishin të dy atje dhe miqësia e gjatë solli krushqinë. Vajza, Sabireja u dha tek miku i tij i hershëm Ibrahim Borshi, ose Leka. Miqësia e lidhur në luftën e përbashkët për çështjen kombëtare, u forcua me krushqi. Dhëndërri, Rakipi, kishte studiuar për drejtësi...Dhe krushqi të tilla vijuan. Mbesa e madhe, vajza e Ismailit, me emrin e bukur Hajali u martua me djalin e Xhaferr bej Ypit, disa herë ministër e kryeministër i vendit. Djali i tij, Tomorri, gjithashtu kishte studiuar për drejtësi. Mbesa tjetër, vajza e dytë e Ismailit u bë nuse e djalit të patriotit kolonjar Zenel bej Prodani, bir i atdhetarit shembullor të Kolonjës, komandantit trim të çetës që luftoi kundër turqve dhe andartëve grek duke lënë dëshmor njërin nga djemtë, Mersinin. Pas dy javësh, në vitin 1914 edhe ai vet e dha jetën në fushën e Prenjasit, si komandant i kolonjarëve përballë rebelëve turkoshak të Haxhi Qamilit, per mbrojtjen e Pogradecit e Korçës. Zenel Prodani ka qene dhe nënprefekt i Lushnjës, ku ka një rrugë me emrin e tij, kryetar bashkie i Shkodrës, prefekt i Elbasanit dhe në fund, edhe i Tiranës. Në këtë familje jetoi si nuse vajza e dytë e Ismailit, Zhaneta. Vajza e tretë, Donika u martua me

nipin e doktor Neki Libohoves, një nga firmëtarët e shpalljes së Pavarësisë në Durrës.

Kur mbeti i ve, Nebi Sefa ishte ende i ri. Martesa me një vajzë nga Tirana flet gjithashtu për statusin social e pasunar të tij. Madje, edhe Qamili, djali i ardhur në jetë nga kjo martesë, u lidh në Tiranë me një vajzë nga fisi Begeja...

Nebi Sefa jetoi midis pronarit të tokave dhe biznesmenit, u end midis Lushnjës dhe Tiranës, por foleja e tij ishte në Lushnjë, ku edhe ndërroi jetë në moshë fisnikërie, 81 vjeç. Pavarësisht suksesit në biznes, ai e donte tokën dhe u dha shumë pas shtimit të saj. Këtë e dëshmon edhe vendimi nr. 16, i 18 qershorit 1945 "Mbi konfiskimin e pasurive të Ismail e Qamil Nebi Sefa..".. Krahas dyqaneve e ndërtesave të tjera, është një listë e pafund tokash, ara, ullishta, kullota...[1] Ka ende disa dokumente arkivore, shkresa zyrtare, madje edhe vendime të gjykatave të kohës etj., ku tregohet se sa i dhënë e këmbëngulës ishte ai kur bëhej fjala për pronësi.[2] Një biznesmen i lindur e një tregtar vullnethekurt. Veç moshës së madhe, edhe kjo ka qënë një arsye e fortë që më 1922, në zgjedhjet për kryetar bashkie, Nebi Sefa mori pak vota.[3] U ndje i lodhur, ndaj u tërhoq dhe nuk u aktivizua në jetën politiko – shoqërore të kohës.



Kjo ishte shtëpia e Nebi Sefës në Lushnjë, 85 vite më parë, ku është sot Zyra Arsimore.

---

[1] GJONI ÇUKO. *Lushnja udhëtim historik. (1944-1950)* Tiranë 2021 f . 50

[2] AQSh. Fnr 156 Viti 1929 Dnr 346 f. 6

[3] ANDREA LIKO NIKO FERRO. *Besim Nuri-Kryetar në dy kongrese*. Tiranë 2020 f. 40

Gjithsesi, në vitin 1925 është i zgjedhur anëtar i këshillit bashkiak dhe më 1928 ndihmon Myftininë e Lushnjës me disa napolona flori...

Si një shqiptar i vërtetë, ai u trondit nga pushtimi fashist i vendit. Ishte afër 80 vjeç, mbante në studio bustin e Skënderbeut dhe nuk e përtypi dot ikjen e mbretit *"për të mirën e vendit"*!. Dhe u tërhoq në fisnikërinë e tij. Pastaj askush nuk dëgjoi më për të, lushnjarin më të kudogjendur në fushën e biznesit, atdhetarin dhe qëndrestarin përballë sfidave të jetës. Fotot e fundit i ka me nipërit dhe mbesat. Adhuronte vazhdimësinë e jetës....

....Ndërsa biznesi i familjes Sefa vetëm lulëzoi. Atë e mori në dorë djali, Ismaili. Peshkimi dhe ndërtimi e bënë të njohur e me peshë firmën "Sefa". Edhe ura e madhe mbi përrua, aty ku është sot, u ndërtua nga kjo firmë dhe ajo e Ahmet bej Resulit. Ishte një shënim mbi beton që e vuloste këtë investim. Veç peshkimit në kënetën e Tërbufit, firma kishte licencën për në disa dalane, nga Saranda, në Shkodër. Sefët ndërtuan në Lushnjë, Durrës, në Elbasan e në Tiranë. Në vitin 1938, me këmbënguljen e palës italiane, u krijua shoqëria aksionere "Peshkalba". Për të lehtësuar "miqtë", ministria jonë e financave rreshtoi edhe disa firma shqiptare, të detyruara të ishin aksionere, deri 49 për qind të vlerës. Këto nuk pranuan. Midis kundërshtuesve të mëdhenj, firma "Sefa" ishte e pakompromis!.

Tërë kohën ai mbeti një lushnjar i lidhur me tokën dhe njerëzit. Në çastet e fundit të jetës, më 1942, la amanet që trupi t'i prehej në kodër, në pronat e tij. Ndaj dhe banesa e fundit ishte në ullishtë, pranë antenave të televizionit në veri të qytetit. Pa asnjë përkujdesje, gjithçka humbi në batërdinë e mosmirënjohjes. Ndërkohë që Nebi Sefa meritonte altarin. Një surprizë të bukur përbën vlerësimi i qeverisë angleze, në vitin 1923. Bashkë me dy lushnjarët e tjerë, zotin Ferit Vokopola dhe zotin Qemal Mullaj ata u shpallën si personalitete me ndikim në histori. Shtatëdhjetë vite më vonë, shteti shqiptar i jep Urdhrin "Për veprimtari patriotike", Klasi i parë, ndërsa në vitin 2012, në 100 – vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë, firmëtari i saj, lushnjari fisnik nderohet me titullin e lartë "Nderi i Kombit". Në bulevardin kryesor të Lushnjës, në hyrje të rrugës së shtëpisë së Kongresit, është vendosur busti i tij, vepër vlerëplot e skulptorit të njohur Maksim Bushi. Një portret dinjitari i derdhur në bronz...

I ati bëri shumë për arsimimin e Nebiut, sidomos në gjuhën amtare. I edukuar me këtë ndjenjë, ky vet, deri në fund të jetës pati një raport të ngushtë me shkollën shqipe. Në fillimet e shekullit të ri, mbi dyzetvjeçar, ai ishte bashkë me lushnjarët në ballë të lëvizjeve antiosmane. Pas përplasjeve të vitit 1906, tok me vëllanë u izoluan në Janinë. Po "nuk zuri mend", as nuk u urtësua, përkundrazi. Me t'u liruar, Nebiu vendosi të çelë një shkollë ku të mësohej shqip. Me mbështetjen edhe të të atit, arriti ta realizonte dëshirën e vet. Në vitin 1907 në Lushnjë, më shumë fshehurazi e në kundërshtim me vullnetin e nënprefektit, në depot e Sefëve u mblodhën mbi dhjetë fëmijë. Mësuesi i shkollës greke, zoti Jak Bardheni, beratasi i urtë, e mori përsipër detyrën. Atëherë Nebi Sefa liroi dhoma të hotelit dhe rreth 20 fëmijë nisën të shkruajnë gjuhën e nënës. Ai garantoi edhe pagesën e mësuesit. Vite më vonë, i biri i tij, Ismaili, biznesmen i njohur në Itali, do t'i dërgonte të birit, zotit Nebi Sefa këtë letër. Janë pak radhë, shkruar me shqipen e gati një shekulli më parë, të cilat nuk kanë nevojë për koment.

*"Po ju tregoj një ndodhi me baban tem [Nebiun]. I shtytur prej lakmijet e dëshirës së un jam Shqiptar e duhet të mësoj Shqip. I thom tim eti pse baba të krishterët që thon se jan grekër mësojmë në shkollën e tyre greqishtë e neve shqiptarët mësojnë një gjuhë të huaj – Kjo ndoshta me [...] se shkolla greqisht ishte afër 100 metro me shtëpinë tonë e ajo turqisht ishte 300 metra lark dhe un çdo mëngjes piqesha me [] krishterët që vinin në shkollën e tyre, babaj më tha se këtu deri para ca viteve s'kishin shkollë fare, aty ku mësoi ti quhet mejtep, [hapur më 1870 shënim autorët] dhe asaj i kanë mbetur vetëm hajrat. Babai im më tha: gjyshi yt ca kohë më parë i është dashur të shkonte në Berat që të mësonte. Ty të duket lark shkolla. Unë i thash jo baba nuk për largësinë e kam për të mësuar Shqip".*

Hapja e shkollës shqipe pa lejen e Stambollit dhe në mes të qytetit, (Lushnja sapo e kishte marrë këtë status), ndeshi në kundërshtimin e autoriteteve osmane. Nënprefekti u hodh në sulm. Ai i shkroi menjëherë Portës së Lartë. "Na shpëtoni nga një zullumqar, që na pengon të mësojmë gjuhën e besimin tonë dhe u mëson të rinjve gjuhën e mallkuar shqipe." Stambolli reagoi ashpër; shkolla u mbyll dhe zoti Nebi Sefa u internua për së dyti herë në Janinë. Natyrisht që nuk u thye, aq më pak të tërhiqej nga udha e nisur. I vëmendshëm si një rilindas, Nebiu u mbush me gëzim kur mësoi për Kongresin e Manastirit, që njihet si kuvendi i alfabetit shqip. Nuk vonoi t'i shkruante mikut të hershëm Feim Bej Zavalani. "Me bekimin e Zotit,


u përmbush dëshira e shqiptarëve për të shkruar gjuhën e Kristoforidhit dhe të Naimit me alfabetin e zëmrës". Një vit më vonë, më një dhjetor 1909, pionieri i arsimit shqip, Nebi Sefa ishte i ftuar nderi në ceremoninë e hapjes së Shkollës Normale në Elbasan.


Kjo marrëdhënie me shkollën shqipe, me shkrimin dhe leximin e saj, e shoqëroi zotin Nebi Sefa tërë jetën. Pas vitit 1935, kur Lushnja kishte një sistem modest shkollash, ai hodhi idenë e ndërtimit të bibliotekës së qytetit. Ishte gati të ngrinte godinën dhe ta pajiste vet me një sasi librash. Madje nisi edhe të përzgjedh e të blejë titujt më të pëlqyer. Një tjetër firmëtar, energjiku Ferit Vokopola ka lënë në dorëshkrim këta rreshta: "Patrioti lushnjar Nebi Sefa më pati treguar mua dëshirën e madhe për ngritjen e një ndërtese në funksion të një biblioteke për qytetin e Lushnjës, në vendin e dyqaneve që kishte kundrejt kishës ortodokse, pra në sheshin e pazarit dhe donte ta pajiste atë me libra të dobishme për rritjen e dijes".[4]

Ishte koha kur shumë gjëra po lëviznin shpejt dhe ethet e luftës u ndjenë afër. Gjithsesi, pas luftës, kur nisi jetë biblioteka publike e qytetit, në inventarin e saj, bashkë me librat e falura nga Libohovët, ishin edhe librat që u gjetën në shtëpinë e zotit Nebi Sefa. Kur po afronte të tetëdhjetat, ai i kujtoi të birit, Ismailit, ëndërron e hershme të ndërtimit të një shkolle të re. Me këtë ëndërr ndërroi jetë. Ismaili këmbënguli edhe një herë. Sipas dokumentit të ruajtur në arkivin e shtetit, më 1943 ai i është drejtuar Ministrisë së Arsimit për një leje të tillë.

---

[4] REVISTA "NJERIU". "*Nga historia e bibliotekave ne Shqiperi*", Nr 9 (21) Mars Tirane 1944 f. 5-6





Faksimilja e letërkëmbimit për ngritjen e bibliotekës në Lushnjë

Në nëntor 1912, kur Ismail Qemali dhe patriotë të tjerë i shtuan përpjekjet për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, në Lushnjë u ngrit një forum atdhetar. Në fakt, intelektualët e njohur të kohës vijonin të mblidheshin tek hani i zotit Qemal Mullaj dhe debatet ishin tërë nerv e shqetësim. Aty u ngjiz Këshilli i Vendit, i cili u formua në nëntor 1912 dhe kishte në përbërje burrat më në zë të kohës : Nebi Sefa, Vasil Gjeçi, Besim Nuri, sheh Ibrahimin, Qemal e Zija Mullaj, Vasil Lala, Ali e Ferit Vokopola, Halit efendi Gramshi (Libohova), papa Jovani, Sulejman Korreshi, Haxhi e Sejfulla Imshta e të tjerë. Disa prej tyre, sidomos më të rinjtë kërkonin që të veprohej shpejt me zëvendësimin e administratës osmane. Kërkonin edhe largimin e trupave pushtuese nga Lushnja...

Por kryefjala ishte shpallja e Pavarësisë së vendit dhe Këshilli ishte "tërë sy e vesh" pranë hapave të Ismail Qemalit. Siç e deklaron vet në intervistën e dhënë gazetës italiane "*Il Piccolo*" më 20 nëntor 1912, vetëm pak orë para nisjes për në Shqipëri, ky ishte i vendosur që me të zbritur në Durrës, të shpallte menjëherë pavarësinë. Kur u mësua se Babai i kombit la Durrësin pa e shpallur pavarësinë dhe u nis për në Vlorë, Nebi Sefa përjetoi një shqetësim të madh. Shqetësimi kishte të bënte me jetën e Ismail Qemalit dhe ndofta, edhe me fatet e vendit.

Sepse osmanët kishin dhënë alarmin dhe urdhri i ardhur nga komandanti i ushtrisë turke në Janinë, si qendër e vilajetit, kërkonte prerë arrestimin e Ismail bej Qemalit sapo ai të futej në tokat e Lushnjës. Këtu, në fshatin Gramsh mbaronte juridiksioni i vilajetit të Manastirit dhe niste ai i Janinës. Detyra i ngarkohej Beratit dhe që andej urdhër – ekzekutimi mbërriti në Lushnjë. Ishte si një gur prove që vërtetoi burrërinë dhe trimërinë e fisnikëve të mençur lushnjarë. Ndonjëherë rastësia është mbreti i botës. Tamam në atë kohë, komandant i xhandarmërisë së Lushnjës ishte kapiten Ibrahim Borshi, miku i zotit Nebi. Ai e mori urdhrin, por nuk mendoi zbatimin e tij. Përkundrazi, vendosi ta mbrojë e shpëtojë Plakun e Flamurit. Për të qetësuar eprorët osmanë, kapiteni nisi në kufirin e fshatit Gramsh nëntoger Mefail Agan, ndërkohë që i dërgoi lajm mikut të vet. Nebi Sefa nuk vonoi për t'u nisur. Pavarësisht vështirësive të motit, lushnjari serioz e i gjindshëm, e mori rrugën mbi kalë. Siç është e njohur dhe e dokumentuar, ditën tjetër këto urdhra u zhbënë, por ama gjëma mund të kishte ndodhur...

Në fillim Nebi Sefa u trondit. Në Durrës kishte qënë e pamundur të ngrihej flamuri kombëtar, ja tani edhe urdhër – arresti për labin tradhtar të Turqisë e armik të Portës së Lartë. Ai nxitoi që të takohej sa më parë me karvanin e nisur nga Durrësi dhe u lumturua kur e pa mirë Kryeatdhetarin. Ata u takuan duke e parë

njëri - tjetrin në sy dhe pastaj Nebi Sefa i puthi duart mikut të shtrënjtë duke u drithëruar. Ja si e tregon këtë ngjarje një tjetër firmëtarë i Pavarësisë, zoti Qemal Karaosmani, i cili më vonë do të bëhej krushk i zotit Nebi Sefa. Në kujtimet e tij "Një udhëtim historik prej Durrësi në Vlorë", dhënë për botim gazetës "Arbëria" në 28 nëntor 1936, Qemal Karaosmani shkruan: "Sa kaluam Kavajën, tek ura e Draçit takojmë Nebi Sefën që vinte prej Lushnje; e prezantova me Ismail Qemal beun dhe e pyetëm nëse i kishte parë shokët qe ishin përpara,dhe Nebiu i tha qe po ju presin te Hani i Gosës se bashku me Dervish bej Biçakçiun qe kish ardhë nga Çerma për ti marrë. Ismail Beu kaloi përpara ndërsa unë me Nebi Sefën mbetem ne një ane gardhi e me tha se ishte nisur apostafat nga Lushnja për te njoftuar urdhrin qe kish ardhur nga Janina Beratit dhe Berati Lushnjës për zbatim qe Ismail benë me shoke ti zini ja gjallë ja vdekur. Komandant i xhandarmerisë në Lushnje ishte Kapiten Ibrahim Leka nga Borshi qe si ushtarak duhej të zbatonte urdhrin por nga ana tjetër si shqiptar donte te ngrihej flamuri dhe lajmëroi mikun e tij Nebi Sefa qe unë do nis një force ne komandën e togerit Mefail Agait te dislokuar ne Gramsh të Lushnjës por ju lajmëroni Ismail beun me shoke te ndërrojnë rrugën në Çerme. Ndërsa po bisedonim me zotin Nebi për situatën shoh një bujk timin që vinte nga Krutja me kalë dhe më dorëzoi një letër që kishte sjellë nga Berati për mua. Letra ishte nga Azis Pashë(Vrioni) dhe Baki Efendiu...Atëherë i transmetova Ismail beut lajmin e sjellë me Nebi Sefën nga kapiten Ibrahim Leka për kthimin e rrugës në Çermë dhe letrën e Azis Pashës dhe Baki Efendiut që rekomandonin për mos me rrezikue, te ktheheshin në Durrës e të futen në Konsullatën Austro - Hungarisë. Mbasi dëgjoi dy njoftimet, plaku që kërkonte në çdo vendim dhe mendimin e shokëve, më pyeti, ti si thua? Unë ju përgjigja..., por në situatën qe na paraqitet duhet te vendosni vete. Plaku si u mendua pak me tha : Unë erdha këtu për një ide për shpëtimin e Shqipërisë; nëse kthehem mbrapa e futem ne Konsullatën e Austrisë ideja e shpëtimit atdheut të shtrenjtë mbaron bashke me mua,nëse ja arrimë Vlones qoftë dhe sikur te vritem do bëhem dëshmor theror për atdheun tim dhe nëse ja mbërrimë Vlones gjalle ideja ime është realizuar dhe Shqipëria e shpëtuar. A ka rruge tjetër përveç Lushnjës qe mos ndeshemi me ushtrinë? Ka i thashë, është devijimi ne Çermë nga Karatopraku por është e vështirë kalimi i renduar nga shirat...Hajde marsh me tha andej do kalojmë. Atë natë Ismail Qemal beu e një pjese e madhe shokëve ndejtem ne konakët e Dervish Beut (Biçaku) dhe shume te tjerë ne konakët e Behxhet bej Hydit ne Çermë. Gjithë natën po mendonim për rrugën e mundimshme dhe lajme vinin nga fshatarë që uji në

Sulzotaj shkonte deri në shalë të kalit, atë natë arritën tek ne dhe mjaft burra nga Lushnja si Halit Efendi Libohova (Gramshi). Të nesërmen në të gdhirë vjen një korrier një bujk i çiflikut tim të Krutjes së Sipërme që më sjellë një letër nga im vëlla Galip Karaosmani që ishte major i rezervës të batalionit të Lushnjës në Berat. Letra ishte nga Azis Pasha dhe Baki Efendiu qe njoftonin qe kishte ardhë urdhër i ri nga Janina qe Ismail beun me shokë ti nderoni. Mbas pak vjen ne Çerme tek ne toger Mefail Agai nga Gramshi per ti puthur dorën Ismail beut. Ne situatën e ndodhur shume u gëzuan se do kalonin nga Lushnja qe i prisnin mbare populli e paria. Por plaku nuk ju nda vendimit për kalim nga Karatopraku mbasi mendònte se mosnjoftimi i dytë mos ishte ndonjë rreng i Janinës për ti kapur gafil. U nisem nga Karatopraku dhe rrema e Sulzotajt na arrinte vërtete uji deri ne shale te kalit veçse nuk kishte rrymë te na merrte. Me gjithë vështirësitë e mëdha të rrugës arritëm ne Libofshë dhe kaluam natën e fjetëm ne konakët e vakëfit qe kish ndërtuar Nedim bej Leskoviku kur ishte administrator i tokave vakëf te Valide Sulltanës (nënës sulltaneshë),tani atje kishte një drejtor turk. Te nesërmen u nisëm herët për te kaluar Semanin tek Vau Petovës me qellim te drekonim ne Fier e ne darke t'ja arrinim...".


Kështu, pra, zoti Nebi Sefa e kreu në kohë dhe mirë këtë detyrë patriotike. Karvani i nisur nga Durrësi, rreth 40 - 50 shpirt, nuk u fut në Lushnjë. Me ndihmën e popullsisë vendase, besnike dhe mikpritëse, ata qëndruan një natë në Çermë. Të nesërmen paradite hodhën vaun në Toçe, toponim që përmendet edhe sot aty ku kalohet rruga nga Çermë - Shkumbini për në Shënepremte. Edhe këtë rast e veçon Qemal Karaosmani. "...pasi rrahëm mendimet e të gjithëve, vendosëm t'i binim nga Karatopraku, duke marrë me vete edhe një fuqi të konsiderueshme për çdo eventualitet". Dihet që kjo fuqi e konsiderueshme ishin trimat myzeqarë. Të betuar në qëllimin e shënjtë e në besë të njëri - tjetrit, duke ecur rrëzë kodrave të Karatoprakut, të shoqëruar nga patrioti divjakas Koli Sako, të gjithë mbërritën shëndoshë e mirë në Libofshë.

Që në Çermë, Ismail Qemali dha porosinë për parinë e Lushnjës. Me që trupat sërbe po përparonin edhe në Shqipërinë e Mesme, le të ngrihej flamuri kombëtar e të shpallej mëvetësia e kazasë sa më parë. Vet zoti Nebi ishte nisur për t'i qëndruar pranë Babait të kombit, por me porosi të tij, u kthye në Lushnjë. Dhe dihet që në Lushnjë ky akt i lartë atdhetar u realizua më 27 nëntor 1912, pikërisht nga burrat e Këshillit të Vendit...Përballë kësaj të vërtete thërrmohet tymnaja

dashakeqe për "beun turkoshak" Nebi Sefa, i cili donte t'ua dorëzonte Ismail Qemalin autoriteteve osmane! Sot ngjan qesharake, por fatkeqësisht kjo njollë turpi mbeti e tillë për 48 vite me radhë të shtetit monist të diktaturës komuniste.....

... Dhe, ndërsa flamurtarët me grupin e vet dhe me një pjesë të delegatëve vijonin udhën e shenjtë drejt Vlorës, në Lushnjë Këshilli mori disa vendime të rëndësishme. Veç zbatimit të porosisë për ngritjen e flamurit kombëtar dhe shpalljes së mëvetësisë, duhej që ky vendim t'u bëhej i njohur autoriteteve osmane, fuqive të mëdha të kohës dhe miqve në Tiranë, Durrës, Elbasan etj.[5]

Dokument që paraqesim e që botohet për herë të parë, është njëri dëshmive të vendimeve të asaj dite.



Njoftim për shpalljen e Pavarësisë së Lushnjes

Menjëherë duheshin caktuar edhe delegatët për në Vlorë. Elementi i krishterë, fatkeqësisht, u mënjanua. U caktuan zoti Nebi Sefa, tashmë 51 - vjeçar, Qemal Mullaj dhe një djalë i ri, Ferit Vokopola. Ata u nisën menjëherë. Natyrisht me kuaj


---


[5] AQSh. Fnr 103 Viti 1912 Dnr 99 f. 1

"Kajmekamit të Kazasë së Lushnjës. Me mirësinë e Zotit nga sot u shpall pavarësia në emër të Shqipërisë. Deri sa të formohet qeveria e përhershme, punët e qeverisë, rendit dhe qetësisë publike i lihen administratës aktuale. Për këtë arsye të urdhërojnë qeveri ekzekutive. Më 14 Teshrinisani 328 [27 Nëntor 1912][5]

dhe me disa trima shoqërues. Ishte një udhëtim mes shiut, baltës dhe të ftohtit. Po kur
mendja dhe zemra janë ngrohtë, pengesat kalohen edhe më lehtë...

Ishte e enjte, 28 nëntor 1912. Dita e Flamurit, e quajmë që prej 111 vitesh ditën e Shpalljes së Pavarësisë kombëtare. Ngritja e flamurit kuq e zi u parapri nga një kuvend në divanhane, pra prej mbledhjes së delegatëve të ardhur nga trojet shqiptare. Aty u vendos për pavarësinë dhe këtë e tregon edhe teksti i deklaratës së hartuar në çast dhe lexuar nga Luigj Gurakuqi, sekretari i kuvendit. *"Pas fjalëvet që tha z. Kryetari, Ismail Kemal Beu, me të cilat tregoi rrezikun e math në të cilin ndodhet sot Shqipëria, të gjithë delegatët në një za venduan që Shqipëria me sot të bahet më vete, e lirë dhe e mosvarme".*





Tek "të gjithë delegatë që në një za venduen..." ishte edhe Nebi Sefa. Siç e tregon dokumenti origjinal, një fletë fletoreje e pamjaftë për një tekst të tillë, ai ka

firmosur Nebi Sefa, Lushnja, duke e përmendur qytetin të cilin përfaqësonte, si rrallë delegatë të tjerë.

Edhe për këtë duhet t'i themi faleminderit. Në ato firma të arta është edhe gjurma e Lushnjës sonë!...

Kaq. Ai e kishte përmbushur detyrën e shenjtë ndaj atdheut. Tani secili duhet të bënte punën e tij dhe Nebi Sefa u kthye në vendlindje. Në kokë i lindnin dhe iknin plot mendime, që gjatë rrugës endeshin, siç thotë poeti "nga kokrra e grurit, gjerë tek qeveria / nga lëmi fshatit, gjerë tek gjithësia". Kujtonte përplasjet me osmanët në Lushnjë dhe syrgjynin e tij e të vëllait në Janinë, hapjen e shkollës shqipe dhe ridënimin, mendonte kryengritjet popullore dhe sjelljet e dhunshme të administratës, që përdori ushtrinë kundër popullit e sidomos të parisë që i organizoi. Burgosje, syrgjyn, konfiskime pasurie...

Po ja, kaq ishte. Ndodh që njeriu kënaqet edhe me pak, mjafton të jetë ajo që i do zemra. Pa le kur bëhet fjalë për lirinë e vatanit!...

Ai vet nuk pati ndonjë iluzion se mund të bëhej pjesë e administratës së re. Ndaj sa më shumë i afrohej Lushnjës, aq më qartë i rendiste punët e shtëpisë, së pari ato që donin mendjen dhe vullnetin e tij. Vijoi bizneset, duke iu përshtatur kushteve të reja. Fëmijët ende ishin të vegjël, i madhi vetëm 10 vjeç.

Por nuk qe e thënë. Për Shqipërinë e re nuk kishte qetësi. Qeveria e Vlorës, të cilën ai e deshi dhe e mbështeti, ra shpejt. Si mallkim për shqiptarët, qejfmbeturi i madh, sedërliu shumë i mbrapshtë, Esat pashë Toptani iu kundërvu me armë. Nebi Sefa me të tijtë i bëri qëndresë në Lushnjë. Amullia pushtoi tërë jetën në vend dhe, sikur të mos mjaftonte kjo, ja edhe Haxhi Qamili me mbrapshtinë e vet e me taborre sherrxhinjsh të pashpirt! Dihet që lushnjarët u organizuan dhe u bënë qëndresë disaditore. Nënshkruesi i Pavarësisë u qëndroi hordhive dumbabase si një kundërshtar i pakompromis. Dhe ata u hakmorën sipas mënyrës së tyre. I dogjën shtëpinë dhe i vodhën të gjithë mallin që gjetën nëpër dyqane. Nebi Sefa u dënua me vdekje. Ishin miqtë nga paria e vendit që e strehuan dhe e shpëtuan nga hakmarrja e primitivëve turkoshakë. Kjo qëndresë ishte një tjetër gjurmë e artë që ai la në jetën e vet prej patrioti konsekuent. Dhe kështu mbeti deri në fund të jetës, fisnik...



Me mbesën, përpara shtëpisë në Tiranë

*Kliti Nushi*

# NEBI ISMAIL SEFA



Atdhetar e luftëtar për çlirimin e Shqipërisë nga zgjedha osmane. Lindi në qytetin e Lushnjës në vitin 1870.

Figura e patriotit Nebi Sefa është e njohur jo vetëm në Myzeqe, por dhe më gjerë. Veprimtarinë patriotike e filloi që në moshë të re. Bënte pjesë në pleqësinë e qytetit. Ishte një nga anëtarët e parisë së qytetit dhe të Myzeqesë, që ka mbrojtur të drejtat e popullit ndaj pushtuesve osmanë. Ka qenë pjesëmarrës në demonstratën e Lushnjës, të majit 1906. Mbas shtypjes së kësaj demonstrate, osmanllinjtë arrestuan shumë myslimanë të krishterë lushnjarë, të cilëve u dhanë dënime të ndryshme. Nebi Sefën dhe të vëllanë, bashkë me shumë lushnjarë të tjerë, i internuan në Janinë.

Pasi kreu dënimin, Nebiu u kthye në Lushnjë dhe e drejtoi

edhe më shumë aktivitetin e tij antiosmanë për pavarësinë e Shqipërisë. Gjatë viteve 1910-1912 lëvizjet antiosmane, si në gjithë Shqipërinë, edhe në Myzeqe u shtuan së tepërmi. Si rezultat, forcat e bashkuara të çetave të Myzeqesë sulmuan garnizonin turk të Lushnjës, duke çliruar qytetin në korrik të vitit 1911. Për organizimin e këtij sulmi të përbashkët luajti rol të madh Nebiu, i cili punoi për koordinimin e veprimit të forcave të fshatit dhe të qytetit, që perfundoi me fitoren e kryengritësve. Kjo fitore e ngriti lart moralin e popullit kryengritës të Myzeqesë, i cili e rriti më shumë luftën deri në sigurimin e pavarësisë.

Njoftimi nga ana e Ismail Qemalit për të shpallur pavarësinë dhe nisja e tij në Vlorë u mor vesh në Janinë. Komanda turke urdhëron telegrafisht që Ismail Qemali të mos kalonte për në Vlorë për të ngritur flamurin, por të arrestohej sapo të futej në Lushnjë. Ky urdhër u zbulua nga patriotët lushnjarë, të cilët e shoqëruan dhe e siguruan gjatë kalimit nga një rrugë tjetër të bregdetit.

Nebi Sefa ishte përfaqësues i popullit të Lushnjës në Kuvendin Kombëtar të Vlorës, ku nënshkroi dokumentin historik të shpalljes së Pavarësisë më 28 nëntor 1912 dhe të krijimit të qeverisë së Ismail Qemalit, e para pesë shekujve robërie.

Nebi Sefa është një nga organizatorët kryesorë të mbrojtjes së Qeverisë së Ismail Qemalit.

Ai dha një kontribut të madh edhe për organizimin e Kongresit të Lushnjës. Përkrahu Luftën e Vlorës për çlirimin nga pushtuesit italianë, siç mbështeti edhe Revolucionin Demokratik të Qershorit të vitit 1924.

Është shquar gjithnjë për qëndrimin e tij demokrat.

Vdiq më 2 nëntor 1942.

**Propozim për shpallje "Qytetar Nderi" pas vdekjes Ikonom Kozma Dhima**

Ikonom Kozma Dhima

Është një ndër figurat më të shquara të historisë së Myzeqesë së Lushnjës, që, për nga përmasa, nuk është më e vogël se ajo e At Stathi Melanit të Kolonjës. Gjatë fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX Ikonom Kozma Dhima nga fshati Sinanbejlli i krahinës së Libofshës radhitej mes figurave më të shquara atdhetare të Myzeqesë. I fjalës, por dhe i pushkës, të gjitha i pat vënë në shërbim të çështjes kombëtare. Emri i këtij kleriku dhe mësuesi dëshmohet në kapërcyell të dy shekujve, XIX dhe XX, shpesh si ideator e organizator e shumë më shpesh edhe si bashkëpunëtor në veprime atdhetare. Pavarësisht kërcënimeve me jetë, ai kurrë s'u step. Prift, por edhe mësues.

I mbrujtur me idetë më përparimtare të Rilindësve të mëdhenj, At Kozma Dhima e mbajti përherë ndezur llambën e dritës së arsimit shqip në Myzeqe. Kisha s'e pengoi t'u mësonte fshehurazi fëmijëve gjuhën e ëmbël shqipe. Shenjtorët i shikonte jo vetëm te ikonat e kishës, por edhe te "altari" i madh i jetës. Në protestën e myzeqarëve lushnjarë të vitit 1906 ishte një prej organizatorëve më kryesorë. Sipas dokumenteve të kohës, kjo protestë "kishte në thelb motive kombëtare". Pikërisht për këtë shkak edhe u përhap me shpejtësi në të gjithë Sanxhakun e Beratit. Qeveritarët osmanë, tepër të vëmendshëm ndaj lëvizjeve të Ikonomit, jo një herë patën vendosur të hakmerreshin ndaj tij. E vlerësonin si një të krishter kokëkrisur. Dhe nuk munguan ta internonin në qytetin e Korçës me akuzën "turbullues i miletit"! Por fjala e sinqertë e klerikut të bekuar ishte njësh me atë të atdhetarit të betuar. Të krishterë e myslimanë ishin në Korçë, por kjo s'e pengoi të internuarin Kozma Dhima të lidhte miqësi me tërë patriotët e asaj ane. Pasi kthehet prej internimit, At Kozmaj vendoset me banim në Stan – Manastir. Tanimë do të ishte një shërbestar i devotshëm i fesë. Natyrisht, jo për t'i mbetur rob vetëm fesë. Altari i kishës për të ishte shumë i vogël përpara atij të Atdheut.

Aty nga viti 1906, gjatë një periudhe të shkurtër, patrioti Kozma Dhima shërbeu mësues në Divjakë. Nuk e lanë gjatë: kishte "devijuar" nga rruga! Ishte koha, kur banorë të fshatrave të Karatoprakut kishin krijuar një çetë për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Myslimanë e të krishterë bashkë, sikundër At Stath Melanin në Kolonjë, e pranuan komandant të çetës. E pranuan, nga që kishin bindjen se ky klerik besonte njësoj për fe dhe Atdhe. Në korrik të vitit 1908 Ikonom Dhima bashkë me të tjerë patriotë me emër u mblodhën në fshatin Zharrnec, aktualisht fshat i bashkisë së Divjakës. Dhe vendosën aty që në Myzeqe të çeleshin shkolla shqipe në Libofshë, Grabian, Divjakë, Karavasta, Kolonjë e në të tjerë fshatra.

Rezultatet e kësaj mbledhjeje u dukën më 1908 me hapjen e së parës shkollë shqipe në Myzeqe në fshatin Libofshë. Ndërkohë që në agim të shekullit të kaluar kishin nisur të vepronin Çetat e para të Lirisë, formimi i çetave antiosmane vazhdonte edhe në Myzeqe. Ishte koha që në krye të këtyre çetave duheshin komandantë të zotë. Ja, për këtë arsye Ikonom Kozma Dhima u qe drejtuar me thirrje burrërore disa prej ushtarakëve shqiptarë që vazhdonin të shërbenin në ushtrinë osmane. Në një letër që ky i drejtonte Kapiten Zija Mullait, shkruante: ***"Unë ndonëse jam prift, por kur e lyp nevoja bëhem edhe komandant, edhe oficer, edhe ushtar për nevojat e kombit shqiptar. Lëreni ushtrinë turke dhe merrni forcat shqiptare; mjaft qëndruat me ta; ejani këtu në Lushnje, se po ju presim!"*** Dhe kjo thirrje nuk qe pa rezultat. Qenë disa që iu bashkuan kryengritësve shqiptarë. Ende pa u harruar protesta e vitit 1909 në Myzeqe, At Kozmaj së bashku me të tjerë kryengritës arritën në muajin korrik të vitit 1911 çlirimin disaditorë të qytetit të Lushnjës. Mesazhi i këtij veprimi në popull dhe tek autoritetet osmane qe i qartë: dita e mëvetësisë kombëtare nuk do të ishte e largët. Edhe pse i veshur me rrason e zezë të priftit, Kozma Dhima vepronte njësoj brenda e jashtë kishës. Te rruga e drejtë e atdhetarit shikonte edhe udhën e ndershme të perëndisë. Në fundnëntorin e vitit 1912, mes mjaft të tjerëve, ai priti e shoqëroi Plakun e Flamurit – Ismail Qemalin, gjatë kohës kur ky kaloi zonës së Libofshës për në Vlorë. Në rrugën drejt viteve që hapnin shekullin XX, At Kozmaj, fetar e atdhetar njëherësh, nuk mund të mos merrte në dorë "fenerin" e dritës së diturisë. Arsimi ishte në gjendje të mjerueshme. Pranë kishave mësohej greqisht! Pranë xhamive – turqisht! Iu përgjigj thirrjes së ministrit të Arsimit, Luigj Gurakuqi, për hapjen e shkollave shqipe. Ka të dhëna, se së toku edhe me atdhetarë të tjerë të krahinës kontribuoi për çeljen e një shkolle shqipe në mjediset e brendshme të Manastirit të Ardenicës. Morali i tij fetar s'e pengonte të shfrytëzonte çdo mjet në shërbim të qëllimit të bekuar. Më 1914, kur andartët grekë po i afroheshin Beratit, së bashku me Zija Mullain shkuan fshat më fshat të Myzeqesë, mblodhën vullnetarë të shumtë, u dolën përpara pushtuesve dhe i shtynë nga erdhën. Pikërisht në këtë kohë dhespoti i Beratit, Joakim Martiniani, një armik i betuar i Ikonom Dhimës, e pezulloi nga detyra dhe e la pa punë deri në vitin 1916! Pas hyrjes së ushtrisë austro – hungareze në Shqipëri, Ikonom Dhima thirret nga nënprefekti i Lushnjës, Izet Zavalani, një patriot i njohur, i cili i jep gradën Kryeprift. Ndërkohë, i kërkon hirësisë së tij që të caktonte vendet se ku mund e duheshin rihapur shkollat shqipe. Mirëpo, nuk qe e thënë: pa kaluar shumë kohë, të nxitur edhe nga dhespoti i Beratit, austro – hungarezët e arrestojnë Ikonomin së bashku me familjen e vet, duke e dërguar në burgun e Rrogozhinës! Teksa futej te të shtatëdhjetat, Ikonom Kozma Dhima nuk ishte thjesht një person. Tanimë ai ishte personalitet. S'kishte ngjarje historike, për të cilën s'do t'i merrej mendimi. Mendimi dhe veprimi. Thirrjes për organizimin e Kongresit Kombëtar në Lushnje

iu përgjigj pozitivisht. Dhe mori pjesë në të gjitha mbledhjet që u organizuan në Teqenë e Karbunarës. Autoritetin e vet e vuri në shërbim të organizmit të të gjithë asaj pune që u bë për pritjen dhe përcjelljen e delegatëve të Kongresit. Në vitin 1921, teksa ndihej i sëmurë dhe i lodhur nga jeta, tërhiqet për pak kohë për t'u rehatuar në shtëpinë e vet në fshatin Stan Manastir. Gjithsesi, një zë i brendshëm e thërriste të dilte jashtë derës së shtëpisë, sigurisht jo për t'u mbyllur në kishë, por për t'u rikthyer mësues në shkollën e Manastirit të Ardenicës. Shkoi, por do të qëndronte vetëm tre vjet. Kish vendosur të tërhiqej përfundimisht nga jeta aktive mes kolegëve. Më 22 shkurt të vitit 1925, i kërrusur nga barra e rëndë e punëve të shumta e me plot rreziqe, por i rrethuar nga kujdesi i familjarëve, ndërroi jetë. Atyre çasteve të fundit kishte lënë amanet që trupi i tij i pajetë të prehej në oborrin e jashtëm të Manastirit të Ardenicës.